

**NJOFTIM**  
**Nr. 65, datë 12.2.2020**

**PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR AUTORIZIMIN E  
ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE QË DO TË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE  
PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHETI**

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në bazë të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe VKM-së nr. 55, datë 6.2.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, bën publik njoftimin si më poshtë:

Të gjitha organizatat jofitimprurëse, që janë të interesuara të aplikojnë për të marrë autorizim nga ministri i Drejtësisë për të ofruar ndihmën juridike parësore, duhet të plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 15, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

**Procedura dhe dërgimi i dokumentacionit:**

Dokumentacioni që duhet të depozitojnë organizatat jofitimprurëse (OJF), për aplikim, për marrjen e autorizimit që lëshohet nga ministri i Drejtësisë, për të ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, përmban:

- a) aktin e regjistrimit në gjykatë;
- b) kopjen e statutit, ku specifikohet si pjesë e veprimtarisë së ofrimit të ndihmës juridike;
- c) dokumentacionin që provon përvojë në ofrimin e ndihmës juridike parësore, të paktën në 3 (tri) vite të veprimtarisë së tyre, duke përfshirë, si më poshtë vijon:
  - i. listën e plotë të projekteve të ndihmës juridike parësore të zhvilluara nga organizata gjatë 3 (tri) viteve dhe të dhëna statistikore për përfituesit e ndihmës parësore;
  - ii. raportet përfundimtare për secilin nga projektet e listuara, si dhe pasqyrat financiare;
  - iii. buxhetin total të secilit projekt, donatorët përkatës, si dhe listën e ekspertëve të brendshëm dhe të jashtëm të përfshirë në këto projekte;
  - iv. letra vlerësimi nga të paktën 2 (dy) subjekte përfituese;
- ç) vërtetimin nga organet tatimore që i ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet;
- d) vërtetim nga gjykata se nuk është në procedurë falimenti dhe/ose likuidimi;
- dh) vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv nuk janë në proces hetimi apo gjykimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike;
- e) formularin e gjendjes gjyqësore të anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv.
- f) adresën elektronike të komunikimit.

Aplikimi për autorizim, i shoqëruar me dokumentacionin e sipërpërmendur, dorëzohet pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, në adresën: bulevardi “Zogu i Parë”, pranë Ministrisë së Drejtësisë, **brenda 40 ditëve nga data e publikimit të njoftimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.**

Aplikimet e paraqitura jashtë afatit nuk kualifikohen.

**Shënim.** Çdo ndryshim në adresën e DNJF-së do të njoftohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.